

Kthim pergjigje nr. 164

Fri 4/3/2020 11:09 AM

To:gazmira sokoli <gazmirasokoli@hotmail.com>;

Përshëndetje Zj. Sokoli!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në adresën email te zyres se shtypit ne Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 164, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ne baze te Ligjit Nr. 9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH”, i ndryshuar, neni 31 “E drejta për konfidencialitetin e të dhënave”, çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga Administrata Tatimore.

Sa me sipër Administrata Tatimore, nuk mund të verë në dispozicion të dhëna konfidenciale të tatimpaguesve konkrete. Për këtë arsye për pikat 2 dhe 3 të kërkesës tuaj nuk mund të gjenerojmë informacion.

Nderkohe për pikën 1. “Vlera totale e tatimit mbi fitimin e tatimpaguesve të cileve i aplikohet, gjatë viteve 2013-2019, i shprehur me vete për secilin vit. Për secilin vit të shprehet dhe shkalla e tatimit mbi fitimin në fuqi. Nëse një vit ka patur më shumë se një shkallë, vlera të jepet sipas shkallëve”, referohuni të dhënave të tabelës si më poshtë vijon:

viti	Nr i tatimpaguesve	Pagesa TF	Norma e Tatimit mbi Fitimin sipas Viteve
2013	3,939	3,481,138,919	10%
2014	4,683	4,674,512,734	15%
2015	12,324	25,096,496,229	15%
2016	12,972	29,391,849,078	15%
2017	14,311	31,599,398,087	15%
2018	15,458	34,406,490,098	15%
2019	16,521	36,479,872,719	5% dhe 15%

Faleminderit për mirëkuptimin.